

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenin 4, paragrafi 3, të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars 2020, miratoi këtë:

UDHËZIM

PËR KLASAT E SIGURIMIT

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktoj me tutje klasifikimin e llojeve të rreziqeve në klasa të sigurimeve, në pajtim me nenet 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet.
2. Dispozitat e këtij udhëzimi aplikohen për siguruesit e licencuar që ushtrojnë veprimtari të sigurimeve në Republikën e Kosovës.
3. Përcaktimet e këtij udhëzimi për siguruesit, aplikohen edhe për risiguruesit.

Neni 2

Klasat e sigurimit

1. Klasat e sigurimeve ndahen në:
 - 1.1 Klasat e sigurimit të jo-jetës; dhe
 - 1.2 Klasat e sigurimit të jetës.

Neni 3

Klasat e sigurimit të jo-jetës

1. Ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Sigurimet, veprimtaria e sigurimit të jo-jetës përfshin klasat e sigurimit si më poshtë:

- 1.1 Sigurimi i aksidenteve;
- 1.2 Sigurimi shëndetit;
- 1.3 Sigurimi i mjeteve tokësore të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina;
- 1.4 Sigurimi i mjeteve lëvizëse mbi shina;
- 1.5 Sigurimi i avionëve;
- 1.6 Sigurimi i anijeve (mjeteve lundruese);
- 1.7 Sigurimi i mallrave në transport;
- 1.8 Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës;
- 1.9 Sigurimi i dëmtimeve të tjera të pasurisë;
- 1.10 Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i automjeteve (mjeteve motorike tokësore);
- 1.11 Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i avionëve;
- 1.12 Sigurimi i përgjegjësive për anijet (mjeteve lundruese) detare, të liqeneve dhe të lumenjve si dhe ato të kanaleve;
- 1.13 Sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme;
- 1.14 Sigurimi i kredive;
- 1.15 Sigurimi i garancioneve;
- 1.16 Sigurimi i humbjeve të ndryshme financiare;
- 1.17 Sigurimi i mbrojtjes ligjore;
- 1.18 Sigurimi i asistencës në udhëtim.

Neni 4

Klasat e sigurimit të jetës

1. Ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Sigurimet, veprimtaria e sigurimit të jetës përfshin klasat e sigurimit si më poshtë:
 - 1.1. Sigurimi i jetës;
 - 1.2. Sigurimi i martesës- lindjes;
 - 1.3. Sigurimi i jetës i lidhur me ndërmarrjet e investimeve kolektive;
 - 1.4. Anuitetet;
 - 1.5. Sigurimi shtesë i cili lidhet me kontratën e sigurimit të jetës;
 - 1.6. Veprimtaritë tjera të sigurimit të jetës.

Neni 5
Llojet e rreziqeve në klasat e sigurimit jo-jetë

1. Llojet e rreziqeve brenda klasave të sigurimit të jo-jetës, ndahen si më poshtë:
 - 1.1. **Sigurimi i aksidenteve** - përfshinë sigurimin e aksidentit në rast të lëndimit në punë dhe sëmundjet e profesionit si dhe mbulon:
 - 1.1.1. Përfitimin e menjëhershëm të plotë të një shume të caktuar monetare;
 - 1.1.2. Përfitimin me natyrë rimbursimi (pagesa e shumës së sigurimit me këste);
 - 1.1.3. Përfitimin e kombinuar, të paraparë në paragrafin 1, nënparagrafin 1.1, nën-nënparagrafët 1.1.1 dhe 1.1.2. të këtij neni;
 - 1.1.4. Përfitimin ndaj lëndimeve, çrregullimeve shëndetësore ose vdekjes së pasagjerëve; që përbëhen si në vijim:
 - 1.1.4.1. Sigurimi i individëve nga pasojat e aksidenteve në vend të punës apo jashtë vendit të punës;
 - 1.1.4.2. Sigurimi i individëve nga pasojat e aksidenteve të mjeteve motorike dhe aksidenteve të profesioneve specifike;
 - 1.1.4.3. Sigurimi i fëmijëve dhe studentëve nga pasojat e aksidenteve dhe sigurimi i veçantë i të rinjve nga pasojat e aksidenteve;
 - 1.1.4.4. Sigurimi i mysafirëve, vizitorëve të performancave dhe shfaqjeve, pjesëmarrësve në ekskursione dhe turistëve nga pasojat e aksidenteve;
 - 1.1.4.5. Sigurimi i konsumatorëve, abonentëve, përfituesve të shërbimeve publike, etj. nga pasojat e aksidenteve;
 - 1.1.4.6. Sigurimet tjera të veçanta nga pasojat e aksidenteve;
 - 1.1.4.7. Sigurimi i detyrueshëm i pasagjerëve në transportin publik nga pasojat e aksidenteve, përfshirë vdekjen si pasojë e aksidentit;
 - 1.1.4.8. Sigurimet tjera nga pasojat e aksidenteve.
 - 1.2. **Sigurimi i shëndetit** - është sigurim që në rast të sëmundjeve, lëndimeve dhe aksidenteve tjera mbulon:
 - 1.2.1 Të ardhurat fikse financiare nga paaftësia shëndetësore;
 - 1.2.2 Përfitimin me natyrë rimbursimi;
 - 1.2.3 Përfitimin e kombinuar, të paraparë në këtë nënparagraf, nën-nënparagrafet 1.2.1 dhe 1.2.2;
 - 1.2.4 Shpenzimet mjekësore, farmaceutike dhe teknike-mjekësore (ambulatore dhe hospitalore);
 - 1.2.5 Sigurimin për kompensimin e shpenzimeve në rast të lëndimeve në punë dhe sëmundjeve profesionale;

- 1.2.6 Sigurimin shtesë për diferencën mbi vlerën dhe të drejtat e shërbimeve shëndetësore të mbuluara nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor;
 - 1.2.7 Lloje të tjera të sigurimeve shëndetësore vullnetare.
- 1.3 **Sigurimi i mjeteve motorike tokësore të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina** – është sigurim që mbulon dëmtimet ose humbjet në:
- 1.3.1 Mjetet tokësore motorike;
 - 1.3.2 Mjetet tokësore jo-motorike;
 - 1.3.3 Kasko (ang; CASCO – Causality and Collision) e mjeteve nga nën nënparagrafët 1.3.1 dhe 1.3.2 të këtij paragrafi.
- 1.4 **Sigurimi i mjeteve lëvizëse mbi shina** - është sigurim i cili mbulon të gjitha dëmet dhe humbjet në mjetet lëvizëse mbi shina, dhe përfshin:
- 1.4.1 Sigurimi kasko i mjeteve lëvizëse mbi shina.
- 1.5 **Sigurimi i avionëve** - është sigurim i cili mbulon të gjitha dëmtimet dhe humbjet në mjetet ajrore dhe mjetet tjera të transportit ajror, dhe përbëhet nga:
- 1.5.1 Sigurimi i aeroplanëve dhe mjeteve tjera të transportit ajror (fluturakeve);
 - 1.5.2 Sigurimi kasko i aeroplanëve dhe mjeteve tjera ajrore.
- 1.6 **Sigurimi i anijeve (mjeteve lundruese)** – është sigurim i cili mbulon të gjitha dëmet dhe humbjet që ndodhin apo shkaktohen në trupin e anijeve apo mjeteve tjera lundruese dhe përbëhet nga:
- 1.6.1 Sigurimi i anijeve lumore dhe të kanaleve;
 - 1.6.2 Sigurimi i anijeve të liqeneve;
 - 1.6.3 Sigurimi i anijeve detare;
 - 1.6.4 Sigurimi kasko i anijeve dhe jahteve të transportit detar;
 - 1.6.5 Sigurimi kasko i anijeve dhe barkave të transportit në lumenj;
 - 1.6.6 Sigurimi kasko i anijeve dhe barkave të transportit në liqene;
 - 1.6.7 Sigurimi kasko i anijeve në ndërtim;
 - 1.6.8 Sigurimi kasko i platformave;
 - 1.6.9 Llojet tjera të sigurimit kasko të mjeteve lundruese.
- 1.7 **Sigurimi i mallrave në transport (përfshirë mallra, bagazhe dhe të gjitha llojet e tjera të sendeve)** është sigurim i cili mbulon të gjitha dëmet dhe humbjet e mallrave gjatë transportit ose të bagazheve, pavarësisht nga mënyra e transportit, dhe përbëhet nga:
- 1.7.1 Sigurimi i mallrave gjatë transportit detar;
 - 1.7.2 Sigurimi i mallrave gjatë transportit ajror;

1.7.3 Sigurimi i mallrave gjatë transportit tokësor;

1.7.4 Sigurimi i mallrave në ruajtje;

1.7.5 Llojet tjera të sigurimit të mallrave në transport.

1.8 Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës është sigurim që mbulon dëmtimet apo humbjet e shkaktuara në sendet apo pasuritë, të ndryshme nga dëmtimet e përfshira në klasat e përcaktuara në paragrafët 1.3 deri 1.7 të këtij neni, të shkaktuara nga: zjarret, shpërthimet, stuhitë, forcat e natyrës të ndryshme nga stuhitë, energjisë nukleare, rrëshqitja e tokës dhe tërmeti; dhe përbëhet nga:

1.8.1 Sigurimi i pasurisë nga zjarret dhe forcat e natyrës që nuk përfshinë industrinë dhe zeje;

1.8.2 Sigurimi i pasurisë nga zjarret dhe forcat e natyrës në industri dhe zeje;

1.8.3 Llojet tjera të sigurimit nga zjarri dhe forcat e natyrës.

1.9 Sigurimi i dëmtimeve të tjera të pasurisë mbulon të gjitha dëmtimet ose humbjet në pasuri, të ndryshme nga dëmtimet e përfshira në klasat e përcaktuara në nën-paragrafët 1.3 deri 1.7 të këtij paragrafi, kur dëmi është shkaktuar nga breshëri, përmbytjet ose nga ngrica dhe çdo ngjarje e tillë, si vjedhje të ndryshme nga ato të përmendura në klasën e përcaktuar në nënparagrafin 1.8 të këtij paragrafi; dhe përbëhet nga:

1.9.1 Sigurimi nga prishja e makinerisë;

1.9.2 Sigurimi nga vjedhjet dhe grabitjet;

1.9.3 Sigurimi nga thyerja e xhamave;

1.9.4 Sigurimi i shtëpisë;

1.9.5 Sigurimi i objekteve në ndërtim;

1.9.6 Sigurimi i objekteve në montim;

1.9.7 Sigurimi i industrisë së filmit;

1.9.8 Sigurimi i mallrave në miniera;

1.9.9 Sigurimi i pajisjeve teknologjike;

1.9.10 Sigurimi i mallrave në kamionët frigoriferë;

1.9.11 Sigurimi i kulturave bujqësore dhe i plantacioneve,

1.9.12 Sigurimi i kafshëve,

1.9.13 Dëmtimet tjera të pasurisë.

1.10 Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i automjeteve (mjeteve motorike tokësore) mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i mjeteve motorike që ecin mbi tokë përfshirë përgjegjësitë e transportuesit dhe mbulimin e përgjegjësive të detyrueshme dhe përbëhet nga:

- 1.10.1 Sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik ndaj palëve të treta;
 - 1.10.2 Sigurimi vullnetar i përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik ndaj palëve të treta;
 - 1.10.3 Sigurimi i përgjegjësisë së vozitësit ndaj mallrave të transportuara me transportin rrugor;
 - 1.10.4 Llojet tjera të sigurimit të përgjegjësive nga përdorimi i mjeteve motorike tokësore.
- 1.11 **Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i avionëve** mbulon të gjitha përgjegjësitë, që lindin nga përdorimi i avionëve dhe mjeteve tjera të transportit ajror (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit); dhe përbëhet nga:
- 1.11.1 Sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësisë së pronarit/shfrytëzuesit të avionëve dhe mjeteve tjera të transportit ajror ndaj palëve të treta;
 - 1.11.2 Sigurimi i përgjegjësisë së pronarit/shfrytëzuesit të avionëve dhe mjeteve tjera të transportit ajror ndaj të gjitha detyrimeve (përfshirë përgjegjësinë e bartjes së mallrave të transportuara përmes transportit ajror);
 - 1.11.3 Lloje tjera të sigurimit të përgjegjësive nga përdorimi i avionëve dhe mjeteve tjera të transportit ajror.
- 1.12 **Sigurimi i përgjegjësive për anijet (mjeteve lundruese) detare, të liqeneve dhe të lumenjve si dhe ato të kanaleve** mbulon të gjitha përgjegjësitë, që lindin nga përdorimi i anijeve (mjeteve lundruese), që lundrojnë në det, liqene, lumenj dhe kanale lundrimi (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit), dhe përbëhet nga:
- 1.12.1 Sigurimi i përgjegjësisë së pronarit/shfrytëzuesit të anijeve (mjeteve lundruese) ndaj palëve të treta;
 - 1.12.2 Sigurimi i përgjegjësisë së pronarit/shfrytëzuesit të anijeve (mjeteve lundruese) ndaj mallrave të transportuara me anije (mjete lundruese);
 - 1.12.3 Llojet tjera të sigurimit të përgjegjësisë për anijet (mjeteve lundruese) detare, të liqeneve dhe të lumenjve si dhe ato të kanaleve.
- 1.13 **Sigurimit të përgjegjësive të përgjithshme** përfshinë sigurimin që mbulon të gjitha përgjegjësitë tjera përveç përgjegjësive të përmendura në nënparagrafet 1.10, 1.11 dhe 1.12 të këtij paragrafi, dhe përbëhen nga:
- 1.13.1 Sigurimi ndaj përgjegjësisë kontraktuale të kontraktorëve të ndërtimit;
 - 1.13.2 Sigurimi ndaj përgjegjësisë kontraktuale të kontraktorëve të montimit;
 - 1.13.3 Sigurimi i përgjegjësisë së prodhuesve të filmit;
 - 1.13.4 Sigurimi i përgjegjësisë së prodhuesve të produkteve;
 - 1.13.5 Sigurimi i përgjegjësisë në transportin hekurudhor;

- 1.13.6 Sigurimi i garancisë për prodhuesit, shitësit dhe furnitorët;
 - 1.13.7 Sigurimi i përgjegjësisë së përgjithshme;
 - 1.13.8 Sigurimi i përgjegjësisë së kompanive të projekteve të inxhinierisë dhe kompanive tjera, ndaj dëmtimeve të shkaktuara për shkak të dokumentacionit teknik të pasaktë;
 - 1.13.9 Sigurimi i përgjegjësisë së kompanive të projekteve të inxhinierisë dhe kompanive tjera;
 - 1.13.10 Sigurimi i përgjegjësisë profesionale për avokat;
 - 1.13.11 Sigurimi i përgjegjësisë së profesionale për noterë;
 - 1.13.12 Sigurimi i përgjegjësisë së profesionale për kompani audituese;
 - 1.13.13 Sigurimi i përgjegjësisë së profesionale për liferim (freight-forwarders);
 - 1.13.14 Sigurimi i përgjegjësisë së pronarit/shfrytëzuesit të marinës;
 - 1.13.15 Sigurimi i përgjegjësisë së riparuesit të anijeve;
 - 1.13.16 Sigurimi i përgjegjësisë së agjentëve të sigurisë dhe detektivëve;
 - 1.13.17 Sigurimi i përgjegjësisë së menaxhimit me patundshmëri;
 - 1.13.18 Sigurimi i përgjegjësisë së doktorëve, dentistëve dhe farmacistëve;
 - 1.13.19 Sigurimi i përgjegjësisë së falimentimit të kreditorëve;
 - 1.13.20 Llojet tjera të sigurimit të përgjegjësisë.
- 1.14 **Sigurimi i kredive** është sigurim i cili mbulon si në vijim:
- 1.14.1 Rrezikun e mos pagesës për shkak të paftësisë paguese;
 - 1.14.2 Kreditë e eksportit dhe rreziqe të tjera, që shoqërohen me eksportin;
 - 1.14.3 Kreditë e shlyera me këste;
 - 1.14.4 Kreditë hipotekare dhe kreditë “Lombard”;
 - 1.14.5 Kreditë bujqësore;
 - 1.14.6 Kreditë tjera, dhe përbëhet nga:
 - 1.14.6.1 Sigurimi i kredive për eksport;
 - 1.14.6.2 Sigurimet tjera të kredive;
 - 1.14.6.3 Sigurimi i kredive për banim.
- 1.15 **Sigurimi i garancioneve** mbulon dhe garanton në mënyrë direkte apo indirekte përmbushjen e përgjegjësisë të debitorit; dhe përbëhet nga:
- 1.15.1 Garancionet e drejtpërdrejta;
 - 1.15.2 Garancionet e tërthorta (jo të drejtpërdrejta);

1.15.3 Bondet

1.16 **Sigurimi i humbjeve të ndryshme financiare** mbulon humbjet financiare të shkaktuara si pasojë e:

- 1.16.1 Rrezikut në punësim;
- 1.16.2 Pamjaftueshmërisë së të ardhurave për çfarëdo arsye;
- 1.16.3 Motit të keq;
- 1.16.4 Humbjes së të ardhurave;
- 1.16.5 Shpenzimeve të përgjithshme të vazhdueshme dhe shpenzime të tjera;
- 1.16.6 Shpenzimeve tregtare dhe operacionale të paparashikuara;
- 1.16.7 Humbjes së vlerës në treg;
- 1.16.8 Humbjes nga qiratë ose të ardhurat;
- 1.16.9 Humbjes indirekte nga tregtimi, të ndryshme nga ato të përmendura më sipër;
- 1.16.10 Humbjes financiare, të tjera nga ato tregtare,
- 1.16.11 Llojeve të tjera të humbjeve financiare; dhe përbëhen nga:
 - 1.16.11.1 Sigurimi ndaj humbjeve financiare si rezultat i ndërprerjes së punës për shkak të zjarrit dhe rreziqet tjera;
 - 1.16.11.2 Sigurimi ndaj humbjeve financiare si rezultat i ndërprerjes së punës për shkak të prishjes së makinerive;
 - 1.16.11.3 Sigurimi i ngjarjeve të ndryshme në rast të reshjeve;
 - 1.16.11.4 Sigurimi ndaj dëmeve që rrjedhin nga blerja e monedhave të huaja të falsifikuara;
 - 1.16.11.5 Sigurimi ndaj rrezikut të anulimeve të aranzhimeve turistike të udhëtimit;
 - 1.16.11.6 Llojet tjera të sigurimit ndaj humbjeve financiare.

1.17 **Sigurimi i mbrojtjes ligjore** mbulon:

- 1.17.1 Shpenzimet për shërbimet ligjore dhe ato gjyqësore;
- 1.17.2 Shpenzime për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësore.

1.18 **Sigurimi i asistencës** mbulon ndihmën për personat të cilët kanë vështirësi gjatë udhëtimeve ose në raste të tjera të largësisë nga shtëpia ose vendbanimi i përhershëm si:

- 1.18.1 Sigurimi turistik;
- 1.18.2 Sigurimi i shëndetit në udhëtim;
- 1.18.3 Sigurimi i asistencës gjatë udhëtimeve jashtë vendit të përhershëm apo të përkohshëm të banimit;
- 1.18.4 Sigurimi i rreziqeve tjera turistike.

Neni 6

Llojet e rreziqeve në klasat e sigurimit jetë

1. Llojet e rreziqeve brenda klasave të sigurimit të jetës, ndahen si më poshtë:

1.1 **Sigurimi i jetës** mbulon rreziqet si në vijim:

1.1.1 Sigurimin për vdekjen;

1.1.2 Sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar;

1.1.3 Sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar ose për vdekje të parakohshme;

1.1.4 Sigurimin e jetës me kthim të primeve.

1.2 **Sigurimi i martesës – lindjes** mbulon rreziqet si në vijim:

1.2.1 Shpenzimet që shoqërojnë martesën ose lindjen e fëmijëve;

1.2.2 Përfundimi i kushteve të sigurimit, e cila ka lidhje me arritjen e një moshe të caktuar të fëmijës.

1.3 **Sigurimi i jetës i lidhur me ndërmarrjet e investimeve kolektive** mbulon:

1.3.1 Sigurimin e jetës në rastet kur pagesa e sigurimit lidhet në mënyrë të plotë apo të pjesshme me vlerën e aksioneve apo kuotave të ndërmarrjeve të investimeve kolektive ose me vlerën e aktiveve të mbajtura në një fond të brendshëm nga siguruesi.

1.4 **Sigurimi i anuiteteve mbulon:**

1.4.1 Sigurimin e jetës me elemente kursimi;

1.4.2 Sigurimin e jetës me afat të përcaktuar;

1.4.3 Anuitete të shtyra;

1.4.4 Anuitete të menjëhershme.

1.5 **Sigurimi shtesë i cili lidhet me kontratën e sigurimit të jetës**, duke përfshirë një ose më shumë nga kombinimet e mëposhtme:

1.5.1 Vdekje si rezultat i aksidentit;

1.5.2 Paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti;

1.5.3 Paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një sëmundjeje;

1.5.4 Paaftësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti;

1.5.5 Paaftësi e përkohshme si rezultat i një sëmundjeje;

1.5.6 Paaftësi për të kryer profesionin apo punën si rrjedhojë e dëmtimeve (lëndimeve) trupore;

- 1.5.7 Shërbimet spitalore;
- 1.5.8 Sëmundjet e pashërueshme;
- 1.5.9 Shërbimet mjekësore.

1.6 Veprimtaria e sigurimit të jetës gjithashtu përfshin edhe operacionet e mëposhtme në sigurime:

- 1.6.1 Sigurimi i individëve të bashkuar për qëllime të kapitalizimit të kontributeve të tyre dhe shpërndarjes së aktiveve në raport me fondet e akumuluar midis personave që kanë arritur një moshë të caktuar (të mbijetuarve) ose midis përfituesve të sigurimit në rast vdekjeje të personave të siguruar;
- 1.6.2 Kthimi i kapitalit i cili është një lloj sigurimi për një periudhë të caktuar, ku siguruesi në këmbim të primeve, bie dakord në pagesën e një shume të caktuar në përfundim të periudhës së rënë dakord;
- 1.6.3 Administrimi i investimeve të fondeve të pensioneve dhe në veçanti të aktiveve, të cilat përfaqësojnë rezervat e subjekteve, të cilat kanë ndikim mbi pagesat në rast vdekjeje apo mbijetese apo në rast të mos vazhdimit ose përfundimit të veprimtarisë.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit.

Fehmi Mehmeti
Kryesues i Bordit Ekzekutiv

Udhëzimi u dërgohet:

- Departamentit të Licencimit dhe Standardizimit (DLS), Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (DMS) dhe Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë (DMJ)
- Institucioneve për të cilat është i aplikueshëm (*t'u dërgohet udhëzimi në mënyrë elektronike nga DLS/DMS*)
- Publikut të gjerë (*të publikohet udhëzimi në faqen e internetit të BQK-së nga DMJ*)